

FTESA  
**Platforma e Partneritetit për Integrimin Europian  
dhe  
Konventa Kombëtare për Integrimin Europian  
Kapitulli 23 (Gjyqësori dhe Të Drejtat Themelore)**

**Tema: “Nevoja për miratimin e një Strategjie Kombëtare për Mbrojtjen/Të Drejtat e Viktimave të Krimit”**

*E enjte, 30 mars 2023, 10:00 – 12:00  
Salla Teuta, Tirana International Hotel*

*Lëvizja Europiane në Shqipëri (EMA) dhe Ministria e Drejtësisë së Shqipërisë, në partneritet me Slovak Foreign Policy Association, me mbështetjen financiare të SlovakAid, kanë kënaqësinë t’ju ftojne në sesionin e radhës për Kapitullin 23 me temën “Nevoja për miratimin e një Strategjie Kombëtare për Mbrojtjen/Të Drejtat e Viktimave të Krimit” në kuadër të Konventës Kombëtare për Integrimin Europian dhe Platformës së Partneritetit për Integrimin Europian.*

*Tryezat në kuadër të kapitulli 23 të organizuara në bashkëpunim mes EMA dhe Ministrisë së Drejtësisë, falë përvijës së ekspertëve, po shqyrtojnë dhe diskutojnë tema në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, të dhënave personale, luftën kundër korrupsionit, procesin ‘screening’ dhe reformën në drejtësi. Sesioni i radhës ka në vëmendje çështje që lidhen me mbrojtjen e viktimave të krimit dhe miratimin e Strategjisë për të drejtat e viktimave të krimit.*

*Objektiv kryesor i takimit është ndarja e informacionit me grupet e interesit dhe aktorë me rëndësi, si dhe mundësia për diskutim dhe shkëmbim idesh mes Ministrisë dhe institucioneve të tjera publike të lidhura, me aktorët jo-shtetërorë dhe ekspertin sllovak, i cili do të prezantojë disa shembuj dhe praktika të mira europiane për hartimin dhe miratimin e një Strategjie të tillë.*

*Për arsye logjistike ju lutemi të konfirmoni pjesëmarrjen tuaj në: [info@em-al.org](mailto:info@em-al.org)*

*Gjatë aktivitetit do të ofrohet përkthim i gjuhës angleze.*

## PROGRAMI

### Platforma e Partneritetit për Integrimin Europian dhe

### Konventa Kombëtare për Integrimin Europian

### Kapitulli 23 (Gjyqësori dhe Të Drejtat Themelore)

**Tema: “Nevoja për miratimin e një Strategjie Kombëtare për Mbrojtjen/Të Drejtat e Viktimave të Krimit”**

*E enjte, 30 mars 2023, 10:00 – 12:00*

*Salla Teuta, Tirana International Hotel*

- 09:45 – 10:00** Regjistrimi i pjesëmarrësve
- 10:00 – 10:10** **Hapja e aktiviteti**  
**Znj. Adea Pirdeni**, Zv. Ministre e Drejtësisë (tbc)  
**Z. Gledis Gjipali**, Drejtor Ekzekutiv, Lëvizja Europiane në Shqipëri (EMA)
- 10:10 – 10:30** **Domosdoshmëria për hartimin e strategjisë për viktimat e krimit në Shqipëri në kuadër të procesit të integritit europian**  
**Znj. Elona Hoxha**, Drejtore, Drejtorja e Politikave dhe Strategjive në Fushën e Drejtësisë, Ministria e Drejtësisë
- 10:30 – 10:45** *Diskutim i hapur me pjesëmarrësit*
- 10:45 – 11:30** **Mbrojtja e viktimave të krimit në BE – praktikat më të mira në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të viktimave**  
**JUDr. Tomáš Zábrenszki**, Departamenti i Parandalimit të Krimit në Ministrinë e Brendshme Sllovaqe  
- Legjislacioni kryesor i BE-së për mbrojtjen e viktimave të krimit  
- Strategjia e BE-së për të drejtat e viktimave (2020-2025)  
- Të drejtat e viktimave – promovimi dhe mbrojtja – e drejta për kompensim, mbrojtja, aksesimi në drejtësi, e drejta për informacion etj.  
- Forcimi i bashkëpunimit mes të gjithë aktorëve përkatës (në nivel kombëtar dhe europian)  
- Praktikrat më të mira nga puna dhe roli i një koordinatori për të drejtat e viktimave apo i platformës së BE-së për të drejtat e viktimave
- 11:30 – 12:00** **Diskutim i hapur me pjesëmarrësit nga institucionet, OSHC-të dhe ekspertët kombëtarë**
- 12:00** **Fjalë përmbyllëse dhe kafe**